



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi:050

FASILITIMI I STANDARDEVE TË TË NXËNIT

Objektivat e programit:

Me përvetësimin e këtij programi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje

- Të demonstrojnë njohuri për Standardet fasilituese për zhvillimin profesional, shkathtësitë e nevojshme për ta përmbushur rolin e fasilitatorit shkollor me kolegë për implementimin e risive në mësimdhënie dhe nxënie
- Të demonstrojnë njohuri të bazuara në Standardet, shkathtësitë dhe sjelljet e nevojshme për një zhvillim të fasilitimit efektiv të një mësimdhënësi profesional
- Të hartojnë planin e punës për bashkëpunimin me kolegët në shkollë me qëllim të arritjes së objektivave e reja të të nxënit të përcaktuara nga kurse të fushave të ndryshme të zhvillimit profesional

Përmbajtja:

Kursi në përmbajtjen e vet ka tetë aktivitete përmes të cilave arrihen rezultatet e pritura:

- Standardet e Praktikave të Fasilitatoreve Shkollore – Rishikimi dhe të kuptuarit e Standardeve të Fasilitimit si dhe vendosja e qëllimeve për t'u zhvilluar Profesionalisht në mënyrë që të forcohen shkathtësitë fasilituese.
- Ndikimi i Shkathtësive Relevante – Rishikimi dhe të kuptuarit e natyrës së shkathtësive relevante si dhe ndikimi i tyre në të shpjeguar dhe të mësuarit në Kosovë.
- Barazia Gjinore dhe Fasilitimi – Identifikimi dhe zhvillimi i shkathtësive të nevojshme për të rritur vetëdijen dhe barazimin gjinor në aktivitetet e zhvillimit profesional.
- Portfolio – Vendosja e Portfolios në formë elektronike, në ueb, si vegël e zhvillimit profesional.
- Arti i të Dëgjuarit & të Pyeturit.-Identifikimi dhe të ushtruarit e shkathtësive konstruktive të dëgjuarit dhe të pyeturit, si dhe reflektimi i rolit të tyre në bashkëpunim me kolegët.

- Mentorimi & Avokimi për Mësimdhënie Kualitative.-Zbulimi se si mentorimi dhe avokimi mund të përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet mësimdhënësve, veçanërisht drejt arritjes se qëllimeve për përmirësim të nxënimit.
- Zgjidhja e Konflikteve & Krijimi i Ekipeve.- Identifikimi dhe reflektimi në llojet e zgjidhjeve të konflikteve, dhe pjesëmarrja në aktivitetet e krijimit të ekipit për t'i vërejtur e vlerësuar llojllojshmëritë e punës në ekip.
- Plani i Veprimit.- Përgatitja dhe prezantimi/demonstrimi në grup i një aktiviteti për një takim pune.

Grupi i synuar:

Ky program i dedikohet mësimdhënësve që tregojnë interesim për t'u bërë fasilitatorë të nxënimit në shkolla.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja:

Programi organizohet në formë të një seminari 2 ditor dhe një seminari 1 ditor dhe ka gjithsej **24 orë**.

Certifikimi:

Kusht për certifikim është përmbushja e kriterëve të përcaktuara me Standardet për Certifikimin e Fasilitatorëve të Programit të Arsimit Themelor (BEP).